



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 40

Tiranë – E hënë, 14 mars 2022

## PËRMBAJTJA

|                                                                 |                                                                                                                                                                        | Faqe |
|-----------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Akt normativ i Këshillit të<br>Ministrave nr. 3, datë 12.3.2022 | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021, “Për buxhetin e<br>vitit 2022”.....                                                                               | 6647 |
| Akt normativ i Këshillit të<br>Ministrave nr. 4, datë 12.3.2022 | Për një ndryshim në ligjin nr.113/2021, “Për një ndryshim në ligjin<br>nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”                          | 6653 |
| Akt normativ i Këshillit të<br>Ministrave nr. 5, datë 12.3.2022 | Për disa shtesa në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin,<br>transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të<br>tyre”, të ndryshuar..... | 6653 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 158, datë 12.3.2022     | Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi.....                                                                                                                 | 6656 |





**AKT NORMATIV**  
**Nr. 3, datë 12.3.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA**  
**NË LIGJIN NR.115/2021,**  
**“PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.115/2021, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Nenet 1, 2 e 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

**“Neni 1**

Buxheti për vitin 2022 është:

|             |                       |
|-------------|-----------------------|
| Të ardhurat | 546 811 milionë lekë; |
| Shpenzimet  | 647 694 milionë lekë; |
| Deficiti    | 100 883 milionë lekë. |

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

**Neni 2**

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është:

|             |                       |
|-------------|-----------------------|
| Të ardhurat | 407 179 milionë lekë; |
| Shpenzimet  | 508 062 milionë lekë; |
| Deficiti    | 100 883 milionë lekë. |

**Neni 4**

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2022 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

|                      |                      |
|----------------------|----------------------|
| Të ardhurat gjithsej | 147 203 milionë lekë |
| nga të cilat:        |                      |

|                                          |                      |
|------------------------------------------|----------------------|
| - kontributet                            | 94 119 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit     | 46 484 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 3 100 milionë lekë;  |
| - bonusi i pensionistëve                 | 3 500 milionë lekë;  |
| Shpenzimet                               | 147 203 milionë lekë |

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2022, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

**2. Sigurimi suplementar.**

Të ardhurat gjithsej 7 732 milionë lekë,  
nga të cilat:

|                                          |                     |
|------------------------------------------|---------------------|
| - kontributet                            | 1 896 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit     | 5 636 milionë lekë; |
| - transferta për indeksimin e pensioneve | 200 milionë lekë;   |
| Shpenzime                                | 7 732 milionë lekë. |

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 3 300 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 900 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në përpjesëtim me shpenzimet e drejtpërdrejta.”.

**Neni 2**

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon



## “Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

|                        |                        |
|------------------------|------------------------|
| Grantet                | 13 994 milionë lekë;   |
| Të ardhurat tatimore   | 370 535 milionë lekë;  |
| Të ardhurat jotatimore | 22 650 milionë lekë.”. |

## Neni 3

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

|                                                                          |                       |
|--------------------------------------------------------------------------|-----------------------|
| - shpenzime të buxhetit qendror                                          | 494 612 milionë lekë; |
| - fondi rezervë i buxhetit                                               | 2 650 milionë lekë;   |
| - kontingjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës | 6 000 milionë lekë;   |
| - kontingjencë për risqet e borxhit                                      | 4 800 milionë lekë.”. |

2. Në paragrafin 7, të këtij neni, shifra e fondit të shpronësimeve ndryshon dhe bëhet “... 1 000 milionë lekë ...”.

3. Në fund të nenit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 20 000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat. Fondi i kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, prej 6 000 milionë lekësh, për mbështetjen e shtresave në nevojë, për mbështetjen e sektorit të transportit dhe për mbështetjen e sektorit të bujqësisë përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.

Shumat e shpërndara nga fondet e sipërpërmendura shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen.”.

## Neni 4

Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

## Neni 5

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

## “Neni 14

Fondi rezervë prej 2 650 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Kontingjencia për risqet e borxhit prej 4 800 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjencia për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

## Neni 6

Në paragrafin e gjashtë të nenit 15, shifra “... 810 milionë lekë ...” ndryshohet dhe bëhet “... 600 milionë lekë ...”.

## Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama



## BUXHETI 2022 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

| Kodi      | Emertimi i Institucionit / Programit                                 | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale  |                   | Totali i Shp. Kapitale | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|-----------|----------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------------|-------------------|------------------------|--------------------------------|
|           |                                                                      |                        | Financim i Brendshëm | Financim i Huaj   |                        |                                |
| <b>1</b>  | <b>Presidenca</b>                                                    | <b>227,778</b>         | <b>16,000</b>        | <b>0</b>          | <b>16,000</b>          | <b>243,778</b>                 |
| 01120     | Veprimtaria e Presidentit                                            | 227,778                | 16,000               | 0                 | 16,000                 | 243,778                        |
| <b>2</b>  | <b>Kuvendi</b>                                                       | <b>1,070,244</b>       | <b>283,000</b>       | <b>0</b>          | <b>283,000</b>         | <b>1,353,244</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 393,961                | 283,000              | 0                 | 283,000                | 676,961                        |
| 01120     | Veprimtaria Ligjvënëse                                               | 676,283                | 0                    | 0                 | 0                      | 676,283                        |
| <b>3</b>  | <b>Kryeministria</b>                                                 | <b>351,050</b>         | <b>50,000</b>        | <b>0</b>          | <b>50,000</b>          | <b>401,050</b>                 |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 351,050                | 50,000               | 0                 | 50,000                 | 401,050                        |
| <b>5</b>  | <b>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b>                    | <b>6,617,510</b>       | <b>2,555,844</b>     | <b>2,863,251</b>  | <b>5,419,095</b>       | <b>12,036,605</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 302,294                | 5,000                | 0                 | 5,000                  | 307,294                        |
| 04220     | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit                        | 1,516,431              | 302,509              | 388,014           | 690,523                | 2,206,954                      |
| 04240     | Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes                  | 620,340                | 992,841              | 0                 | 992,841                | 1,613,181                      |
| 04250     | Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.  | 3,594,225              | 945,844              | 2,413,755         | 3,359,599              | 6,953,824                      |
| 04860     | Keshillimi dhe Informacioni Bujqësor                                 | 439,950                | 170,000              | 0                 | 170,000                | 609,950                        |
| 05470     | Menaxhimi qendrushëm i tokës bujqësore                               | 18,000                 | 0                    | 0                 | 0                      | 18,000                         |
| 04230     | Mbështetje për Peshkimin                                             | 126,270                | 139,650              | 61,482            | 201,132                | 327,402                        |
| <b>6</b>  | <b>Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë</b>                     | <b>4,802,051</b>       | <b>24,142,314</b>    | <b>14,043,755</b> | <b>38,186,069</b>      | <b>42,988,120</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 482,050                | 13,000               | 0                 | 13,000                 | 495,050                        |
| 04520     | Transporti rrugor                                                    | 2,552,375              | 15,571,887           | 4,580,132         | 20,152,019             | 22,704,394                     |
| 04540     | Transporti Detar                                                     | 105,435                | 80,000               | 10,000            | 90,000                 | 195,435                        |
| 04550     | Transporti Hekurudhor                                                | 412,853                | 400,000              | 1,958,349         | 2,358,349              | 2,771,202                      |
| 04560     | Transporti Ajror                                                     | 19,793                 | 71,200               | 0                 | 71,200                 | 90,993                         |
| 04610     | Mbështetje për rrjetet e komunikacionit                              | 0                      | 4,000                | 20,000            | 24,000                 | 24,000                         |
| 06370     | Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime                                      | 449,348                | 6,486,185            | 4,219,274         | 10,705,459             | 11,154,807                     |
| 06220     | Menaxhimi i Mbetjeve Urbane                                          | 180,000                | 1,067,042            | 476,000           | 1,543,042              | 1,723,042                      |
| 04320     | Mbështetje për Energji                                               | 52,278                 | 200,000              | 2,780,000         | 2,980,000              | 3,032,278                      |
| 04430     | Mbështetje për Burimet Natyrore                                      | 215,640                | 91,000               | 0                 | 91,000                 | 306,640                        |
| 04440     | Mbështetje për Industrinë                                            | 267,032                | 64,000               | 0                 | 64,000                 | 331,032                        |
| 06180     | Planifikimi Urban                                                    | 65,249                 | 94,000               | 0                 | 94,000                 | 159,249                        |
| <b>10</b> | <b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>                           | <b>60,965,388</b>      | <b>1,945,329</b>     | <b>938,000</b>    | <b>2,883,329</b>       | <b>63,848,717</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 524,654                | 203,000              | 350,000           | 553,000                | 1,077,654                      |
| 01120     | Menaxhimi i Shpenzimeve Publike                                      | 358,721                | 0                    | 0                 | 0                      | 358,721                        |
| 01130     | Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme                                    | 590,000                | 400,000              | 0                 | 400,000                | 990,000                        |
| 01140     | Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore                                    | 2,420,499              | 342,640              | 0                 | 342,640                | 2,763,139                      |
| 01150     | Menaxhimi i të Ardhurave Doganore                                    | 3,600,000              | 153,220              | 120,690           | 273,910                | 3,873,910                      |
| 01160     | Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore                    | 74,675                 | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 76,675                         |
| 04130     | Mbështetje për Zhvillim Ekonomik                                     | 360,070                | 71,800               | 150,000           | 221,800                | 581,870                        |
| 04160     | Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr. | 295,145                | 16,500               | 0                 | 16,500                 | 311,645                        |
| 10220     | Sigurimi Shoqëror                                                    | 46,926,116             | 0                    | 0                 | 0                      | 46,926,116                     |
| 10550     | Tregu i Punës                                                        | 2,302,235              | 71,000               | 0                 | 71,000                 | 2,373,235                      |
| 04170     | Inspektimi në Punë                                                   | 162,397                | 4,500                | 0                 | 4,500                  | 166,897                        |
| 09240     | Arsimi i Mesëm (profesional)                                         | 2,028,478              | 280,669              | 317,310           | 597,979                | 2,626,457                      |
| 06190     | Strehimi                                                             | 1,322,400              | 400,000              | 0                 | 400,000                | 1,722,400                      |
| <b>11</b> | <b>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</b>                       | <b>40,133,522</b>      | <b>3,326,000</b>     | <b>320,000</b>    | <b>3,646,000</b>       | <b>43,779,522</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 699,209                | 80,000               | 0                 | 80,000                 | 779,209                        |
| 09120     | Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)                               | 22,993,152             | 1,108,000            | 0                 | 1,108,000              | 24,101,152                     |
| 09230     | Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)                                      | 6,523,328              | 1,012,000            | 0                 | 1,012,000              | 7,535,328                      |
| 09450     | Arsimi Universitar                                                   | 9,400,000              | 606,000              | 200,000           | 806,000                | 10,206,000                     |
| 09770     | Fonde për Shkencën                                                   | 395,286                | 250,000              | 100,000           | 350,000                | 745,286                        |
| 08140     | Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë                                       | 122,547                | 270,000              | 20,000            | 290,000                | 412,547                        |
| <b>12</b> | <b>Ministria e Kulturës</b>                                          | <b>2,029,191</b>       | <b>2,062,500</b>     | <b>160,000</b>    | <b>2,222,500</b>       | <b>4,251,691</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 158,390                | 0                    | 0                 | 0                      | 158,390                        |
| 08220     | Trashegimia Kulturore dhe Muzete                                     | 605,900                | 20,000               | 65,000            | 85,000                 | 690,900                        |
| 08230     | Arti dhe Kultura                                                     | 1,264,901              | 2,042,500            | 95,000            | 2,137,500              | 3,402,401                      |
| <b>13</b> | <b>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</b>                | <b>73,969,247</b>      | <b>1,342,944</b>     | <b>1,410,000</b>  | <b>2,752,944</b>       | <b>76,722,191</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 336,479                | 3,000                | 0                 | 3,000                  | 339,479                        |
| 07220     | Sherbimet e Kujdesit Paresor                                         | 8,494,649              | 147,052              | 158,000           | 305,052                | 8,799,701                      |
| 07330     | Sherbimet e Kujdesit Dytësor                                         | 30,926,859             | 1,159,212            | 1,152,000         | 2,311,212              | 33,238,071                     |
| 07450     | Sherbimet e Shëndetit Publik                                         | 6,217,174              | 13,680               | 0                 | 13,680                 | 6,230,854                      |
| 07460     | Sherbimi Kombëtar i Urgjencës                                        | 310,159                | 0                    | 0                 | 0                      | 310,159                        |
| 10430     | Perkujdesi Social                                                    | 26,649,602             | 20,000               | 100,000           | 120,000                | 26,769,602                     |
| 01190     | Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik                               | 1,034,325              | 0                    | 0                 | 0                      | 1,034,325                      |
| <b>14</b> | <b>Ministria e Drejtësisë</b>                                        | <b>10,289,872</b>      | <b>476,700</b>       | <b>110,000</b>    | <b>586,700</b>         | <b>10,876,572</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 426,699                | 95,600               | 110,000           | 205,600                | 632,299                        |
| 03310     | Ndihma Juridike                                                      | 76,700                 | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 78,700                         |
| 01120     | Publikimet Zyrtare                                                   | 54,323                 | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 56,323                         |
| 01130     | Mjekësia Ligjore                                                     | 82,650                 | 5,000                | 0                 | 5,000                  | 87,650                         |



| Kodi      | Emertimi i Institucionit / Programit                                    | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale  |                  |                        | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------------|------------------|------------------------|--------------------------------|
|           |                                                                         |                        | Financim i Brendshëm | Financim i Huaj  | Totali i Shp. Kapitale |                                |
| 03440     | Sistemi i Burgjeve                                                      | 5,600,075              | 360,900              | 0                | 360,900                | 5,960,975                      |
| 03350     | Sherbimi i Permbarimit Gjyqësor                                         | 146,454                | 3,000                | 0                | 3,000                  | 149,454                        |
| 01160     | Sherbimet për çeshijet e biresimeve                                     | 14,865                 | 200                  | 0                | 200                    | 15,065                         |
| 01180     | Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave                           | 3,738,620              | 6,000                | 0                | 6,000                  | 3,744,620                      |
| 03490     | Sherbimi i Proves                                                       | 149,486                | 2,000                | 0                | 2,000                  | 151,486                        |
| <b>15</b> | <b>Ministria e Evropës dhe Puneve të Jashtme</b>                        | <b>2,747,931</b>       | <b>91,000</b>        | <b>80,780</b>    | <b>171,780</b>         | <b>2,919,711</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 237,985                | 55,000               | 0                | 55,000                 | 292,985                        |
| 01120     | Mbeshtetje diplomatike jashtë shtetit                                   | 2,238,809              | 15,000               | 0                | 15,000                 | 2,253,809                      |
| 01130     | Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ                               | 193,709                | 0                    | 0                | 0                      | 193,709                        |
| 01150     | Mbeshtetja Institucionale për Procesin e Integritetit                   | 77,429                 | 21,000               | 80,780           | 101,780                | 179,209                        |
| <b>16</b> | <b>Ministria e Brendshme</b>                                            | <b>19,126,568</b>      | <b>960,000</b>       | <b>350,290</b>   | <b>1,310,290</b>       | <b>20,436,858</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 1,167,431              | 96,250               | 0                | 96,250                 | 1,263,681                      |
| 03140     | Policia e Shtetit                                                       | 15,269,090             | 712,750              | 335,290          | 1,048,040              | 16,317,130                     |
| 03150     | Garda e Republikës                                                      | 1,723,855              | 29,000               | 0                | 29,000                 | 1,752,855                      |
| 01160     | Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor              | 489,014                | 62,000               | 15,000           | 77,000                 | 566,014                        |
| 01170     | Sherbimi i Gjendjes Civile                                              | 477,177                | 60,000               | 0                | 60,000                 | 537,177                        |
| <b>17</b> | <b>Ministria e Mbrojtjes</b>                                            | <b>21,586,727</b>      | <b>7,304,500</b>     | <b>1,900,000</b> | <b>9,204,500</b>       | <b>30,791,227</b>              |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 1,316,356              | 220,000              | 0                | 220,000                | 1,536,356                      |
| 02120     | Forcat e Luftimit                                                       | 5,928,739              | 4,652,500            | 1,200,000        | 5,852,500              | 11,781,239                     |
| 09430     | Arsimi Ushtarak                                                         | 803,551                | 390,000              | 0                | 390,000                | 1,193,551                      |
| 02150     | Mbeshtetja e Luftimit                                                   | 5,870,927              | 1,113,000            | 0                | 1,113,000              | 6,983,927                      |
| 07340     | Mbeshtetje për Shëndetësinë                                             | 919,930                | 150,000              | 0                | 150,000                | 1,069,930                      |
| 10270     | Mbeshtetje Sociale për Ushtarakët                                       | 5,200,000              | 0                    | 0                | 0                      | 5,200,000                      |
| 10910     | Emergjencat Civile                                                      | 1,547,225              | 779,000              | 700,000          | 1,479,000              | 3,026,225                      |
| <b>18</b> | <b>Sherbimi Informativ Shtetëror</b>                                    | <b>1,743,455</b>       | <b>50,000</b>        | <b>0</b>         | <b>50,000</b>          | <b>1,793,455</b>               |
| 03520     | Veprimtaria Informativ Shtetërore                                       | 1,743,455              | 50,000               | 0                | 50,000                 | 1,793,455                      |
| <b>19</b> | <b>Drejtoria e Radio Televizionit</b>                                   | <b>567,600</b>         | <b>0</b>             | <b>0</b>         | <b>0</b>               | <b>567,600</b>                 |
| 08310     | Sherbimet për shqiptarët jashtë kufirit                                 | 240,000                | 0                    | 0                | 0                      | 240,000                        |
| 08520     | Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja                      | 197,600                | 0                    | 0                | 0                      | 197,600                        |
| 08330     | Prodhimet filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare               | 67,600                 | 0                    | 0                | 0                      | 67,600                         |
| 08340     | Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografisë                           | 62,400                 | 0                    | 0                | 0                      | 62,400                         |
| <b>20</b> | <b>Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave</b>                              | <b>176,995</b>         | <b>65,000</b>        | <b>0</b>         | <b>65,000</b>          | <b>241,995</b>                 |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 176,995                | 65,000               | 0                | 65,000                 | 241,995                        |
| <b>22</b> | <b>Akademia e Shkencës</b>                                              | <b>142,268</b>         | <b>1,000</b>         | <b>0</b>         | <b>1,000</b>           | <b>143,268</b>                 |
| 01520     | Veprimtaria Akademike                                                   | 142,268                | 1,000                | 0                | 1,000                  | 143,268                        |
| <b>24</b> | <b>Kontrolli i Lartë i Shtetit</b>                                      | <b>445,554</b>         | <b>20,000</b>        | <b>24,000</b>    | <b>44,000</b>          | <b>489,554</b>                 |
| 01120     | Veprimtaria Audituese e KLSH                                            | 445,554                | 20,000               | 24,000           | 44,000                 | 489,554                        |
| <b>26</b> | <b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>                                | <b>1,311,792</b>       | <b>530,740</b>       | <b>490,000</b>   | <b>1,020,740</b>       | <b>2,332,532</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 174,267                | 2,000                | 0                | 2,000                  | 176,267                        |
| 05320     | Programe për mbrojtjen e Mjedisit                                       | 422,008                | 120,000              | 390,000          | 510,000                | 932,008                        |
| 04260     | Administrimi i Pyjeve                                                   | 324,739                | 39,500               | 0                | 39,500                 | 364,239                        |
| 04760     | Zhvillimi i Turizmit                                                    | 390,779                | 369,240              | 100,000          | 469,240                | 860,019                        |
| <b>28</b> | <b>Prokuroria e Përgjithshme</b>                                        | <b>2,170,513</b>       | <b>130,000</b>       | <b>0</b>         | <b>130,000</b>         | <b>2,300,513</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 2,170,513              | 130,000              | 0                | 130,000                | 2,300,513                      |
| <b>29</b> | <b>Këshilli i Lartë i Gjyqësor</b>                                      | <b>3,217,656</b>       | <b>412,000</b>       | <b>0</b>         | <b>412,000</b>         | <b>3,629,656</b>               |
| 01110     | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 263,046                | 15,000               | 0                | 15,000                 | 278,046                        |
| 01140     | Mbeshtetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë                    | 8,444                  | 0                    | 0                | 0                      | 8,444                          |
| 03310     | Buxheti Gjyqësor                                                        | 2,946,166              | 397,000              | 0                | 397,000                | 3,343,166                      |
| <b>30</b> | <b>Gjykata Kushtetuese</b>                                              | <b>146,909</b>         | <b>19,000</b>        | <b>0</b>         | <b>19,000</b>          | <b>165,909</b>                 |
| 03320     | Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese                                       | 146,909                | 19,000               | 0                | 19,000                 | 165,909                        |
| <b>31</b> | <b>Agjensia Telegrafike Shqiptare</b>                                   | <b>56,004</b>          | <b>1,000</b>         | <b>0</b>         | <b>1,000</b>           | <b>57,004</b>                  |
| 08320     | Veprimtaria Telegrafike e RTSH-se                                       | 56,004                 | 1,000                | 0                | 1,000                  | 57,004                         |
| <b>35</b> | <b>Këshilli i Lartë i Prokurorisë</b>                                   | <b>141,625</b>         | <b>8,000</b>         | <b>0</b>         | <b>8,000</b>           | <b>149,625</b>                 |
| 01110     | Veprimtaria e KLP                                                       | 141,625                | 8,000                | 0                | 8,000                  | 149,625                        |
| <b>40</b> | <b>Partite Politike</b>                                                 | <b>356,208</b>         | <b>0</b>             | <b>0</b>         | <b>0</b>               | <b>356,208</b>                 |
| 01110     | Mbeshtetje për Partitë Politike                                         | 345,600                | 0                    | 0                | 0                      | 345,600                        |
| 01120     | Mbeshtetje për Shoqatat                                                 | 8,320                  | 0                    | 0                | 0                      | 8,320                          |
| 01130     | Mbeshtetje për Organizatat e Veteranëve me Status                       | 2,288                  | 0                    | 0                | 0                      | 2,288                          |
| <b>41</b> | <b>Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar</b> | <b>973,971</b>         | <b>30,000</b>        | <b>0</b>         | <b>30,000</b>          | <b>1,003,971</b>               |
| 03390     | Veprimtaria e SPAK                                                      | 973,971                | 30,000               | 0                | 30,000                 | 1,003,971                      |
| <b>50</b> | <b>Instituti Statistikës</b>                                            | <b>1,188,141</b>       | <b>300,000</b>       | <b>400,000</b>   | <b>700,000</b>         | <b>1,888,141</b>               |
| 01320     | Veprimtaria Statistikore                                                | 1,188,141              | 300,000              | 400,000          | 700,000                | 1,888,141                      |
| <b>55</b> | <b>Shkolla e Magjistratës</b>                                           | <b>290,468</b>         | <b>8,000</b>         | <b>0</b>         | <b>8,000</b>           | <b>298,468</b>                 |
| 09820     | Veprimtaria Arsimore                                                    | 290,468                | 8,000                | 0                | 8,000                  | 298,468                        |
| <b>56</b> | <b>Fondi i Zhvillimit Shqiptar</b>                                      | <b>0</b>               | <b>9,000,000</b>     | <b>6,451,924</b> | <b>15,451,924</b>      | <b>15,451,924</b>              |
| 06210     | Programe Zhvillimi                                                      | 0                      | 5,800,000            | 6,451,924        | 12,251,924             | 12,251,924                     |
| 06220     | Infrastruktura Vendore dhe Rajonale                                     | 0                      | 2,800,000            | 0                | 2,800,000              | 2,800,000                      |
| 04230     | Programi "100 Fshatrat"                                                 | 0                      | 400,000              | 0                | 400,000                | 400,000                        |
| <b>57</b> | <b>Qendra Kombëtare e Kinematografisë</b>                               | <b>156,805</b>         | <b>1,000</b>         | <b>0</b>         | <b>1,000</b>           | <b>157,805</b>                 |



| Kodi          | Emertimi i Institucionit / Programit                                                             | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale  |                   |                        | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------------|-------------------|------------------------|--------------------------------|
|               |                                                                                                  |                        | Financim i Brendshëm | Financim i Huaj   | Totali i Shp. Kapitale |                                |
| 08220         | Mbeshtetja e veprimtarisë kinematografike                                                        | 156,805                | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 157,805                        |
| <b>63</b>     | <b>Institucionet e sistemit të drejtësisë</b>                                                    | <b>688,089</b>         | <b>70,000</b>        | <b>0</b>          | <b>70,000</b>          | <b>758,089</b>                 |
| 03320         | Veprimtaria e Zyres së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë                                        | 196,143                | 64,000               | 0                 | 64,000                 | 260,143                        |
| 03330         | Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit                                              | 228,235                | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 230,235                        |
| 03340         | Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar                                                  | 192,576                | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 194,576                        |
| 03360         | Veprimtaria e komisionerit publik                                                                | 71,135                 | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 73,135                         |
| <b>66</b>     | <b>Avokati i Popullit</b>                                                                        | <b>120,838</b>         | <b>4,000</b>         | <b>0</b>          | <b>4,000</b>           | <b>124,838</b>                 |
| 03320         | Sherbimi i avokatise                                                                             | 120,838                | 4,000                | 0                 | 4,000                  | 124,838                        |
| <b>67</b>     | <b>Komisioneri për Mbikqyrjen e Sherbimit Civil</b>                                              | <b>56,858</b>          | <b>1,000</b>         | <b>0</b>          | <b>1,000</b>           | <b>57,858</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 56,858                 | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 57,858                         |
| <b>73</b>     | <b>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</b>                                                            | <b>186,550</b>         | <b>81,500</b>        | <b>0</b>          | <b>81,500</b>          | <b>268,050</b>                 |
| 01610         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 186,550                | 81,500               | 0                 | 81,500                 | 268,050                        |
| 01620         | Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale                                                              | 0                      | 0                    | 0                 | 0                      | 0                              |
| <b>76</b>     | <b>Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave</b> | <b>152,509</b>         | <b>33,000</b>        | <b>0</b>          | <b>33,000</b>          | <b>185,509</b>                 |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 152,509                | 33,000               | 0                 | 33,000                 | 185,509                        |
| <b>77</b>     | <b>Autoriteti i Konkurences</b>                                                                  | <b>69,197</b>          | <b>1,000</b>         | <b>0</b>          | <b>1,000</b>           | <b>70,197</b>                  |
| 04120         | Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences                                                     | 69,197                 | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 70,197                         |
| <b>82</b>     | <b>Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit</b>                                                        | <b>12,054</b>          | <b>1,000</b>         | <b>0</b>          | <b>1,000</b>           | <b>13,054</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 12,054                 | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 13,054                         |
| <b>87</b>     | <b>Institucione të tjera Qeveritare</b>                                                          | <b>5,985,208</b>       | <b>2,221,629</b>     | <b>293,000</b>    | <b>2,514,629</b>       | <b>8,499,837</b>               |
| 01320         | Sherbime Qeveritare                                                                              | 250,000                | 30,000               | 0                 | 30,000                 | 280,000                        |
| 01130         | Sherbimi i Prokurimit Publik                                                                     | 59,820                 | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 60,820                         |
| 05640         | Administrimi i ujërave                                                                           | 93,014                 | 10,000               | 93,000            | 103,000                | 196,014                        |
| 03310         | Sherbimi i Avokatise Shtetërore                                                                  | 212,147                | 2,000                | 0                 | 2,000                  | 214,147                        |
| 01150         | Sherbime të tjera                                                                                | 707,311                | 140,253              | 0                 | 140,253                | 847,564                        |
| 01140         | e-Qeverisja                                                                                      | 4,065,265              | 1,881,376            | 0                 | 1,881,376              | 5,946,641                      |
| 01330         | Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike                                                  | 354,030                | 106,000              | 150,000           | 256,000                | 610,030                        |
| 08610         | Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët                                                                | 110,118                | 50,000               | 50,000            | 100,000                | 210,118                        |
| 08480         | Mbështetje për Kultet Fetare                                                                     | 133,503                | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 134,503                        |
| <b>88</b>     | <b>Mbështetje për Shoqërinë Civile</b>                                                           | <b>121,252</b>         | <b>1,000</b>         | <b>0</b>          | <b>1,000</b>           | <b>122,252</b>                 |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 121,252                | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 122,252                        |
| <b>89</b>     | <b>Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>              | <b>66,962</b>          | <b>6,500</b>         | <b>0</b>          | <b>6,500</b>           | <b>73,462</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 66,962                 | 6,500                | 0                 | 6,500                  | 73,462                         |
| <b>90</b>     | <b>Komisioni i Prokurimit Publik</b>                                                             | <b>66,908</b>          | <b>25,000</b>        | <b>0</b>          | <b>25,000</b>          | <b>91,908</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 66,908                 | 25,000               | 0                 | 25,000                 | 91,908                         |
| <b>91</b>     | <b>Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi</b>                                                | <b>48,119</b>          | <b>3,000</b>         | <b>0</b>          | <b>3,000</b>           | <b>51,119</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 48,119                 | 3,000                | 0                 | 3,000                  | 51,119                         |
| <b>92</b>     | <b>Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit</b>                                            | <b>34,743</b>          | <b>1,000</b>         | <b>0</b>          | <b>1,000</b>           | <b>35,743</b>                  |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 34,743                 | 1,000                | 0                 | 1,000                  | 35,743                         |
| <b>95</b>     | <b>Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit</b>                       | <b>89,507</b>          | <b>12,000</b>        | <b>67,000</b>     | <b>79,000</b>          | <b>168,507</b>                 |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                                          | 89,507                 | 12,000               | 67,000            | 79,000                 | 168,507                        |
| <b>TOTALI</b> |                                                                                                  | <b>264,701,836</b>     | <b>57,593,500</b>    | <b>29,902,000</b> | <b>87,495,500</b>      | <b>352,197,336</b>             |



**TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022**  
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

*ne milion leke (in million lek)*

| Nr.  | E M E R T I M I                                              | Akti Normativ 2022 | Ne % te PBB  | I T E M S                                       |
|------|--------------------------------------------------------------|--------------------|--------------|-------------------------------------------------|
|      | <b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>                                   | <b>546,811</b>     | <b>29.3%</b> | <b>TOTAL REVENUE</b>                            |
| I.   | <b>Te ardhura nga ndihmat</b>                                | <b>13,994</b>      | <b>0.7%</b>  | <b>Grants</b>                                   |
|      | <i>Nga te cilat: mbeshtetje buxhetore</i>                    | <i>2,994</i>       | <i>0.2%</i>  | <i>from which: Budget Support</i>               |
|      | <i>Nga te cilat: grante per fondin e rindertimit</i>         |                    |              | <i>from which: Reconstruction Fund</i>          |
|      | <i>Nga te cilat: projekte te destinuar per investime</i>     | <i>11,000</i>      | <i>0.6%</i>  |                                                 |
| II.  | <b>Te ardhura tatimore</b>                                   | <b>510,167</b>     | <b>27.3%</b> | <b>Tax Revenue</b>                              |
| II.1 | <b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>                               | <b>370,535</b>     | <b>19.8%</b> | <b>From tax offices and customs</b>             |
|      | Tatimi mbi Vleren e Shtuar                                   | 173,061            | 9.3%         | V.A.T                                           |
|      | Tatimi mbi Fitimin                                           | 37,586             | 2.0%         | Profit Tax                                      |
|      | Akcizat                                                      | 58,478             | 3.1%         | Excise Tax                                      |
|      | Tatimi mbi te Ardhurat Personale                             | 47,161             | 2.5%         | Personal Income Tax                             |
|      | Taksa Nacionale dhe te tjera                                 | 46,741             | 2.5%         | National Taxes and others                       |
|      | Taksa Doganore                                               | 7,508              | 0.4%         | Customs Duties                                  |
| II.2 | <b>Te ardhura nga Pushteti Vendor</b>                        | <b>27,632</b>      | <b>1.5%</b>  | <b>Local Taxes</b>                              |
|      | Taksa Lokale                                                 | 21,445             | 1.1%         | Local Taxes                                     |
|      | Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)                              | 6,187              | 0.3%         | Property Tax                                    |
|      | Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel          | 0                  | 0.0%         | Simple profit tax of small business             |
| II.3 | <b>Te ardhurat nga Fondet Speciale</b>                       | <b>112,000</b>     | <b>6.0%</b>  | <b>Revenues from Special Funds</b>              |
|      | Sigurimi Shoqeror                                            | 96,015             | 5.1%         | Social Insurance                                |
|      | Sigurimi Shendetesor                                         | 14,985             | 0.8%         | Health insurance                                |
|      | Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve            | 1,000              | 0.1%         | Revenues for owners' in value-compensation      |
| III. | <b>Te ardhura Jotatimore</b>                                 | <b>22,650</b>      | <b>1.2%</b>  | <b>Nontax Revenue</b>                           |
|      | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise                           | 1,000              | 0.1%         | Profit transfer from BOA                        |
|      | Te ardhura nga Institucionet Buxhetore                       | 12,300             | 0.7%         | Income of budgetary institutions                |
|      | Dividenti                                                    | 300                | 0.0%         | Divident                                        |
|      | Tarifat e Sherbimeve                                         | 3,400              | 0.2%         | Services Fees                                   |
|      | Te tjera                                                     | 5,650              | 0.3%         | Others                                          |
|      | <b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>                                  | <b>647,694</b>     | <b>34.7%</b> | <b>TOTAL EXPENDITURE</b>                        |
| I.   | <b>Shpenzime Korrente</b>                                    | <b>501,549</b>     | <b>26.9%</b> | <b>Current Expenditures</b>                     |
| 1    | <b>Personeli</b>                                             | <b>89,388</b>      | <b>4.8%</b>  | <b>Personnel expenditures</b>                   |
|      | Paga                                                         | 73,743             | 3.9%         | Wages                                           |
|      | Kontributi per Sigurime Shoqerore                            | 12,145             | 0.7%         | Social insurance contributions                  |
|      | Fondi i vecante i pagave                                     | 300                | 0.0%         | Bonus fund                                      |
|      | Politika te reja pagash                                      | 2,400              | 0.1%         | Contingency for new wage policies               |
|      | Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta                        | 800                | 0.0%         | Higher Education from its own revenues          |
| 2    | <b>Interesat</b>                                             | <b>50,757</b>      | <b>2.7%</b>  | <b>Interest</b>                                 |
|      | Te Brendshme                                                 | 27,363             | 1.5%         | Domestic                                        |
|      | Te Huaja                                                     | 18,593             | 1.0%         | Foreign                                         |
|      | Kontingjencë për risqet e borxhit                            | 4,800              | 0.3%         | Contingency for debt related risks              |
| 3    | <b>Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:</b>         | <b>59,643</b>      | <b>3.2%</b>  | <b>Operational &amp; Maintenance of which:</b>  |
|      | <i>Te qeverisjes qendrore</i>                                | <i>53,143</i>      | <i>2.8%</i>  | <i>Central government</i>                       |
|      | <i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>                 | <i>900</i>         | <i>0.0%</i>  | <i>from revenues of Higher Education System</i> |
|      | <i>Twining projects</i>                                      | <i>300</i>         | <i>0.0%</i>  |                                                 |
|      | <i>Kontigjence vaksina</i>                                   | <i>2,700</i>       | <i>0.1%</i>  |                                                 |
|      | <i>Te tjera jashte limitit</i>                               | <i>2,600</i>       | <i>0.1%</i>  | <i>from Exceptional Revenues</i>                |
| 4    | <b>Subvencionet</b>                                          | <b>1,550</b>       | <b>0.1%</b>  | <b>Subsidies</b>                                |
| 5    | <b>Shpenzime per Fondet Speciale</b>                         | <b>212,271</b>     | <b>11.4%</b> | <b>Social insurance outlays</b>                 |
|      | Sigurime Shoqerore                                           | 148,135            | 7.9%         | Social insurance                                |
|      | Politika te reja pensionesh                                  | 3,300              | 0.2%         | Contingency for new pension policies            |
|      | Bonusi i Pensionistev                                        | 3,500              | 0.2%         | Pensioners' Bonus                               |
|      | Sigurime Shendetesore                                        | 52,836             | 2.8%         | Health insurance                                |
|      | Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve              | 4,500              | 0.2%         | Expenditure for owners' in value-compensation   |
| 6    | <b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>                         | <b>60,290</b>      | <b>3.2%</b>  | <b>Local Budget expenditure</b>                 |
|      | Transfertat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor       | 28,028             | 1.5%         | Central Government Grant for Local Government   |
|      | <i>Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme</i>              | <i>18,723</i>      | <i>1.0%</i>  | <i>Unconditional Fund</i>                       |
|      | <i>Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)</i> | <i>9,305</i>       | <i>0.5%</i>  | <i>Specific Grant</i>                           |
|      | <i>Transferte per emergjencat civile</i>                     |                    |              |                                                 |
|      | Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)                 | 27,632             | 1.5%         | Local Budget (Own revenues)                     |
|      | Taksa të ndara                                               | 1,040              | 0.1%         | Local Budget (from shared taxes revenues)       |
|      | Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)              | 2,840              | 0.2%         | Local Budget (from non-tax revenues)            |
|      | Financimi i huaj vendor                                      | 750                | 0.0%         | Local foreign financing                         |
|      | Ndertimi i Teatrit Kombetar (Bashkia Tirane)                 |                    |              |                                                 |
| 7    | <b>Shpenzime te tjera</b>                                    | <b>27,650</b>      | <b>1.5%</b>  | <b>Other expenditures</b>                       |
|      | Pagesa e Papunesise                                          | 900                | 0.0%         | Unemployment insurance benefits                 |
|      | Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia                               | 23,550             | 1.3%         | Social assistance and disability                |
|      | Kompensim per ish te perndjekurit politike                   | 1,000              | 0.1%         | Compensation for ex political prisoners         |
|      | Bonusi i lindjeve                                            | 2,200              | 0.1%         | Birth Bonus                                     |



|      |                                                                       |                  |               |                                             |
|------|-----------------------------------------------------------------------|------------------|---------------|---------------------------------------------|
| II.  | <b>Fondi Rezerve</b>                                                  | <b>8,650</b>     | <b>0.5%</b>   | <b>Reserve fund, Contingency</b>            |
|      | Fondi Rezerve                                                         | 2,650            | 0.1%          | Reserve Fund                                |
|      | Kontigjenca per Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës | 6,000            | 0.3%          |                                             |
| III. | <b>Shpenzime Kapitale</b>                                             | <b>109,496</b>   | <b>5.9%</b>   | <b>Capital expenditures</b>                 |
|      | Financimi Brendshëm                                                   | 57,594           | 3.1%          | Domestic financing                          |
|      | <i>nga e cila: transfer të kapitale</i>                               | 200              | 0.0%          | <i>from which: capital transfer to AIC</i>  |
|      | Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë                          | 1,000            | 0.1%          | From Higher Education System's own revenues |
|      | Financimi Huaj                                                        | 29,902           | 1.6%          | Foreign financing                           |
|      | <i>nga të cilat: Energjia</i>                                         | 2,100            | 0.1%          | <i>from which: Energy</i>                   |
|      | Fondi i Rindertimit                                                   | 20,000           | 1.1%          | Reconstruction Fund                         |
|      | Transfer të kapitale për llogarime speciale të shpronësimeve          | 1,000            | 0.1%          |                                             |
| V    | <b>Të tjera</b>                                                       | <b>28,000</b>    | <b>1.5%</b>   | <b>Other</b>                                |
|      | Hua e dhënë për Energji                                               | 8,000            | 0.4%          | Borrowing to Energy Sector                  |
|      | Hua e kthyer nga sistemi energjistik                                  |                  |               | Repayment from Energy Sector                |
|      | Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik                         | 20,000           | 1.1%          |                                             |
| VI   | <b>Transferta e Shpronësimeve</b>                                     |                  |               | <b>Expropriation Fund</b>                   |
|      | <b>DEFICITI</b>                                                       | <b>-100,883</b>  | <b>-5.4%</b>  | <b>Cash Balance</b>                         |
|      | <b>FINANCIMI DEFICITIT</b>                                            | <b>100,883</b>   | <b>5.4%</b>   | <b>Financing (Cash)</b>                     |
|      | <b>Brendshëm</b>                                                      | <b>100,251</b>   | <b>5.4%</b>   | <b>Domestic</b>                             |
|      | Te ardhura nga privatizimi                                            | 0                | 0.0%          | Privatization receipts                      |
|      | Hua-marrje e brendshme                                                | 50,000           | 2.7%          | Domestic borrowing                          |
|      | Te tjera                                                              | 50,251           | 2.7%          | Other                                       |
|      | <b>I Huaj</b>                                                         | <b>632</b>       | <b>0.0%</b>   | <b>Foreign</b>                              |
|      | Hua afatgjate (e marre)                                               | 25,752           | 1.4%          | Long-term Loan(Drawings)                    |
|      | Ndryshimi i gjendjes së arkës                                         |                  |               | Chang. of stat. Account                     |
|      | Ripagesat                                                             | -42,529          | -2.3%         | Repayments                                  |
|      | Mbështetje buxhetore                                                  | 17,409           | 0.9%          | Budget support                              |
|      | <b>Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)</b>                               | <b>1,867,351</b> | <b>100.0%</b> | <b>Gross Domestic Product (GDP)</b>         |

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 4, datë 12.3.2022**

**PËR NJË NDRYSHIM NE LIGJIN**  
**NR.113/2021, “PËR NJË NDRYSHIM NË**  
**LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998,**  
**“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,**  
**TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 2, të ligjit nr.113/2021, “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, fjalët “... duke filluar nga data 1 korrik 2022 ...” zëvendësohen me “... duke filluar nga data 1 prill 2022 ...”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**AKT NORMATIV**  
**Nr.5, datë 12.3.2022**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.8450,**  
**DATË 24.2.1999, “PËR PËRPUNIMIN,**  
**TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN**  
**E NAFTËS, TË GAZIT DHE**  
**NËNPRODUKTEVE TË TYRE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

**“KREU III/1**  
**SITUATA E VEÇANTË DHE MASAT**  
**PËRKATËSE**

**Neni 21/1**  
**Situata e veçanta**

1. Situatë e veçantë, në kuptim të këtij kreu, janë të gjitha ato situata të cilat krijojnë situatë



emergjente kur tregu hidrokarbur karakterizohet nga:

a) reduktimi i përshpejtuar deri në mungesë i furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre;

b) rritja e ndjeshme e çmimit të tyre në treg;

c) zvogëlimi në mënyrë të ndjeshme i importeve mesatare të naftës/gazit dhe nënprodukteve të tij, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar;

ç) zvogëlimi në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave në përputhje me këtë kre;

d) çdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas.

2. Situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 21/2

##### **Bordi**

1. Në rastin e situatave të veçanta ngrihet dhe funksionon Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim Bordi).

2. Bordi ka në përbërje:

a) ministrin përgjegjës për ekonominë, në cilësinë e kryetarit;

b) ministrin përgjegjës për hidrokarburet;

c) Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;

ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave;

d) 5 përfaqësues nga shoqëritë e hidrokarbureve, ndër të cilët 3 përfaqësues nga shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe 2 përfaqësues të tregtimit me pakicë të hidrokarbureve;

dh) 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, në nivel drejtuesi;

e) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, në nivel drejtuesi të lartë.

3. Bordi mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e tij edhe përfaqësues të tjerë nga institucione shtetërore, ekspertë të fushës apo grupe interesi.

4. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Në rastet e konfliktit të interesit të përfaqësuesve të shoqërive hidro-

karbure, ndaj të cilave merret masë administrative, përfaqësuesi merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjen e Bordit dhe përjashtohet nga vendimarrja.

5. Sekretariati i Bordit të përcaktuar në këtë kre do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

6. Pesë shoqëritë hidrokarbure, të cilat kanë xhiron vjetore më të lartë në vitin paraardhës, dërgojnë emrin e përfaqësuesit të tyre te Sekretariati i Bordit. Mbledhjet e Bordit thirren me kërkesë të ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhe/ose ministrit përgjegjës për ekonominë. Njoftimi për mbledhje duhet të kryhet të paktën 2 (dy) orë para mbledhjes.

#### Neni 21/3

##### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit**

Bordi ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) Të zbatojë metodologjinë e përcaktuar në këtë kre për përcaktimin në transparencë të plotë të çmimit tavan, duke marrë në konsideratë një marzh, i cili mbulon kostot e shoqërisë;

b) Të njoftojë në mënyrë periodike, sipas përcaktimit të Bordit, çmimet tavan, të cilat publikohen në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe në një seksion të veçantë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet. Vendimet e marra nga Bordi i fillojnë efektet ditën pasardhëse ose sipas përcaktimit të vendimit të Bordit;

c) Të vendosë masën administrative, sipas shkronjës “c”, të nenit 21/6, të këtij kreu, që duhet të ndërmerren ndaj shoqërive në rast shkeljeje të parashikimeve të këtij kreu;

ç) Çdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme në bazë të këtij kreu.

#### Neni 21/4

##### **Strukturat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Bordit**

Çmimet e caktuara me vendim të Bordit janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjitha shoqëritë, sipas këtij kreu, dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga shoqëritë gjatë periudhës së masave të veçanta dhe nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, që vepron kryesisht nëpërmjet kontrolleve ose



ankesave nga konsumatorët/qytetarët. Sipas rastit, Bordi mund të urdhërojë një nga strukturat e parashikuara në këtë nen për të kryer verifikime të thelluara në terren.

Neni 21/5

### **Metodologjia e llogaritjes së çmimit**

Bordi cakton çdo javë ose kur e vlerëson të nevojshme, në diskrecion të tij, çmimin tavan për shitjen për gazoilin, benzinën dhe gazin e lëngshëm të naftës, sipas metodologjisë së mëposhtme:

a) Çmimi i shpallur nga bursa në Platts i një dite më parë nga mbledhja e Bordit, në kushtet CIF Med, për gazoilin, e standardit SSH EN 590 2018, benzinën e standardit SSH EN 228 2018 dhe gazin e lëngshëm të naftës përkatësisht propan, butan dhe përzierjen e tyre;

b) Çmimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të këtij neni, i shtohet një vlerë premio prej 20 USD/ton;

c) Për shoqëritë e tregtimit me shumicë lejohej një shtesë jo më shumë se 1 % mbi çmimin e përlllogaritur, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifit, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Për shoqëritë e tregtimit me pakicë lejohej një shtesë jo më shumë se 5% mbi çmimin e përlllogaritur, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21/6

### **Masat e veçanta administrative**

Në rast të mosrespektimit të çmimit tavan përkatës, të vendosur nga Bordi, zbatohen sanksionet e mëposhtme:

a) Shoqëritë e tregtimit me shumicë të produkteve të naftës dhe gazit dënohen me gjobë, në masën 10 (dhjetë) milionë lekë;

b) Shoqëritë e tregtimit me pakicë të produkteve të naftës dhe gazit, të cilat nuk respektojnë çmimin tavan përkatës të vendosur nga Bordi, dënohen me gjobë, në masën 2 (dy) milionë lekë;

c) Në rast përsëritjeje, masave të mësipërme, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, i shtohet edhe heqja e licencës së tregtimit.

Neni 21/7

### **Masat me karakter detyrues**

1. Të gjitha shoqëritë, që tregtojnë me shumicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave përkatëse, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, dhe të ofrojnë këtë shërbim të pandërprerë, në përputhje me vendimet e Bordit.

2. Të gjitha shoqëritë, që tregtojnë me pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar furnizimin e pandërprerë të konsumatorit/qytetarit, në përputhje me vendimet e Bordit.

3. Mosmarrja e masave nga shoqëritë private, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dënohet sipas legjislacionit të fushës dhe këto shoqëri përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. “Albpetrol”, sh.a. me qëllim përmirësimin e situatës me furnizim të hidrokarbureve, ka të drejtë të hyjë në marrëveshje direkte me shoqëri private ose publike.

Neni 21/8

### **Organet kompetente për dhënien e masave administrative**

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 26/1, të këtij kreu, e ka Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

2. Shkeljet e konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që lidhen me masë administrative me gjobë, sipas përcaktimit të nenit 21/6, të këtij kreu, i dërgohen brenda 24 (njëzet e katër) orëve Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, i cili vepron, brenda 5 (pesë) ditëve me marrjen e masës përkatëse, të propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

3. Shkeljet e konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, që lidhen me masën administrative “heqje licence të tregtimit”, i dërgohen brenda 48 (dyzet e tetë) orëve Bordit.

4. Me marrjen e kërkesës sipas pikës 3, të këtij neni, Bordi merr vendim lidhur me masën administrative “heqje licence të tregtimit”. Vendimi



i Bordit i dërgohet për ekzekutim dhe fillimin e procedurës për heqjen e licencës organit kompetent. Akti administrativ i heqjes së licencës merret nga organi kompetent brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljes.

5. Gjobat e dhëna, sipas këtij kreu, përbëjnë titull ekzekutiv dhe modeli i tyre përcaktohet nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

6. Gjobat e mbledhura, sipas këtij kreu, derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

7. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 21/9

#### Vendimarrja nga Bordi

Mbledhjet e Bordit, në cilësinë e organit kolegjial gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së masave të veçanta, realizohet edhe *on-line*, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik/telepunës.

Neni 21/10

#### Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Parashikimet e këtij kreu zbatohen për aq kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë.

2. Zbatimi i parashikimeve të këtij kreu fillon me shpalljen e situatës së veçantë me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfundimi i situatës së veçantë dhe i zbatimit të parashikimeve të këtij kreu përcaktohet me vendim të Bordit.

3. Në çdo rast, ky kre nuk përjashton aplikimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive apo akteve të tjera ligjore, për aq kohë sa nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij kreu.

Neni 21/11

#### Ankimi ndaj masave administrative

Masat administrative me gjobë, të vendosura sipas këtij kreu, ankimohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, ndërsa masat administrative me heqje licence të tregtimit ankimohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 2

#### Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shpallet edhe situata e veçantë, në kuptim të këtij kreu, dhe fillojnë të zbatohen masat me karakter të veçantë, si pasojë e situatës emergjente të tregut hidrokarbur.

Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 158, datë 12.3.2022

#### PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.

2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.

3. Paga bazë minimale orare të jetë 183,9 (njëqind e tetëdhjetë e tre presje nëntë) lekë.

4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

5. Vendimi nr.1025, datë 16.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2022.

KRYEMINISTËR

Edi Rama







*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë